



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 652/4 prot.

Tiranë, më 13.10.2025

VENDIM

Nr.39, datë 13.10.2025

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 53, DATË 23.9.2024**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 53, datë 23.9.2024, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Cërrik dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës”*,

KONSTATOVA SE:

Me Urdhrin nr. 41, datë 21.3.2024, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, në Bashkinë Cërrik”*, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në institucionin Bashkia Cërrik.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 53, datë 23.9.2024, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Cërrik dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës”*, ku janë lënë detyra konkrete për rregullimin e ligjshmërisë.

Me kalimin e afatit të lënë në vendimin e mësipërm, me Urdhrin nr. 62, datë 2.7.2025, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim në lidhje me zbatimin e vendimit paralajmërues*

nr. 53, datë 23.9.2024, të Komisionerit”, Komisioneri ka urdhëruar fillimin e mbikëqyrjes në vazhdim për zbatimin e vendimit paralajmërues nr.53, datë 23.9.2024, në institucionin Bashkia Cërrik, sipas drejtimeve të programit të mbikëqyrjes në vazhdim nr.652/1, datë 2.7.2025, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar Kryetarit të Bashkisë Cërrik me shkresën nr.652/2, datë 2.7.2025, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të vendimit nr. 53 ,datë 23.9.2024 të Komisionerit”*. Mbi bazën e këtyre akteve, grupi i punës u paraqit në subjektin e mbikëqyrjes.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr.53, datë 23.9.2024, si dhe referuar informacionit të administruar në subjekt, konstatohet se situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur paraqitet si më poshtë vijon:

Në **pikën 2** të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar që, për përmirësimin e administrimit të shërbimit civil dhe klasifikimin racional të pozicioneve në përputhje me nenin 19 të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar, dhe pikën 5 të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, njësi përgjegjëse e institucionit (*njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore*), bazuar në orientimet e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, të caktojë personin/at përgjegjës për mbledhjen dhe analizimin e informacionit për secilin pozicion dhe t’ia përcjellë këtë material eprorit direkt dhe Sekretarit të Përgjithshëm për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës.

Vërejt se, njësi e menaxhimit të burimeve njerëzore pranë Bashkisë Cërrik ka përcaktuar grupin e punës përgjegjës për mbledhjen dhe analizimin e informacionit mbi pozicionet e punës në strukturën aktuale të shërbimit civil, i cili, në përfundim të këtij procesi, rezultatet e analizës, që përfshijnë përcaktimin e detyrave, përgjegjësi, nivelit të arsimit, fushës së studimeve dhe përvojës në punë për secilin pozicion, i ka pasqyruar në një raport përmbledhës. Me aktin nr. 95/2 prot., datë 14.1.2025, ky raport i është dërguar Sekretarit të Përgjithshëm dhe të gjithë njësive përbërëse të institucionit me qëllim hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës.

Në **pikën 3** të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga njësi e burimeve njerëzore e institucionit që, pas përfundimit të procesit të hartimit dhe miratimit të përshkrimeve të punës, të përgatisë dokumentacionin e domosdoshëm për kryerjen e procedurës së vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës.

Në zbatim të kësaj pike të vendimit paralajmërues, vërejt se njësi e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ka ndërmarrë masat përkatëse për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për realizimin e procedurës së vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës.

Konkretisht, gjatë verifikimit në subjekt, në dispozicion të grupit të punës është vënë struktura dhe organika e hollësishme e institucionit, e miratuar me urdhrin nr. 69, datë 28.2.2025, *“Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Cërrik për vitin 2025”* në fuqi në momentin e ekzekutimit të vendimit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, si dhe përshkrimet përfundimtare të punës për të gjitha pozicionet e

shërbimit civil (nga grupi i punës u administruan me përzgjedhje 3 përshkrime pune për pozicionet e kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese).

Në **pikën 4** të vendimit paralajmërues Komisioneri ka kërkuar nga Sekretari i Përgjithshëm që, në zbatim të pikës 29/ç të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të ndryshuar, të krijojë Komitetin e vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil, i përbërë nga tre anëtarë: një analist pune ose funksionar i menaxhimit të burimeve njerëzore dhe dy nëpunës civilë me përvojë në institucion.

Në përmbushje të kësaj kërkesë konstatoj se, bazuar në pikën 29/ç, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, me urdhrin nr. 369, datë 31.12.2024, është ngritur Komiteti i Vlerësimit dhe Klasifikimit të pozicioneve të punës të shërbimit civil, si strukturë përgjegjëse për administrimin e procesit të vlerësimit dhe klasifikimit. Ky komitet përbëhet nga tre anëtarë: drejtori i njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore, përgjegjësi i sektorit dhe një specialist i kësaj njësie, duke garantuar përmbushjen e kriterëve të përbërjes dhe përvojës, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Në **pikën 5** të vendimit paralajmërues Komisioneri ka kërkuar që Komiteti i Vlerësimit dhe Klasifikimit, pas administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, të identifikojë vendet e punës që do t'i nënshtrohen vlerësimit, të kryejë vlerësimin mbi bazën e përshkrimeve të punës dhe në zbatim të metodologjisë së përcaktuar në lidhjen 5 të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe në përfundim të hartojë një listë përmbledhëse me klasifikimin racional të pozicioneve të shërbimit civil sipas kategorive dhe klasave përkatëse, në përputhje me ligjin nr.152/2013, të ndryshuar; kjo listë t'i përcillet Sekretarit të Përgjithshëm dhe Njësisë së Burimeve Njerëzore përmes Zyrës së Arkiv Protokollit.

Vërej se, Komiteti i Vlerësimit dhe Klasifikimit të pozicioneve të punës të shërbimit civil, pas administrimit të dokumentacionit të nevojshëm të përcjellë nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, ka realizuar identifikimin e saktë të pozicioneve të punës që i nënshtrohen procesit të vlerësimit.

Në vijim, Komiteti ka zhvilluar procesin e vlerësimit të këtyre pozicioneve, duke u mbështetur në përshkrimet e miratuara të punës dhe në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në lidhjen 5 të vendimit nr. 142/2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe me aktin nr.95/1 prot., datë 14.1.2025, i ka përcjellë njësisë përgjegjëse listën përmbledhëse përfundimtare, në të cilën pasqyrohen të gjitha pozicionet e punës që bëjnë pjesë në shërbimin civil, të klasifikuara sipas kategorive dhe klasave përkatëse, në përputhje me dispozitat e nenit 19 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktin nënligjor të sipërpërmendur.

Në **pikën 6** të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar hartimin dhe miratimin e planit të rekrutimit, në të cilin të përfshihen të gjitha vendet vakante, përfshirë ato të lira

në mënyrë efektive, si dhe ato të plotësuara në kundërshtim me ligjin, në përputhje me strukturën në fuqi në momentin e ekzekutimit të vendimit.

Pas përfundimit të procesit të identifikimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, konstatoj se plani vjetor i pranimeve në shërbimin civil, është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 19, datë 28.3.2025, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me aktin nr 477/1 prot., datë 15.4.2025. Njëkohësisht, grupit të verifikimit i janë vënë në dispozicion vendimi nr.5, datë 25.1.2024, *“Për miratimin e planit vjetor të pranimet në shërbimin civil”*, të Këshillit Bashkiak, së bashku me aktin e konfirmimit nr. 186/1 prot., datë 6.2.2024, të Prefektit të Qarkut Elbasan.

Në **pikën 7**, të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga Kryetari i Bashkisë Cërrik, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit të nxjerra në kundërshtim me ligjin për 19 punonjësit e emëruar në pozicione pune të shërbimit civil.

Nga analiza e të dhënave të administruara vërej se Kryetari i Bashkisë Cërrik ka konstatuar pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit të nxjerra në kundërshtim me ligjin dhe ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit me shërbimin civil për punonjësit si më poshtë:

- Me urdhrin nr. 276/1, datë 2.9.2024, për punonjësen Marjeta Mema;
- Me urdhrin nr. 276/2, datë 2.9.2024, për punonjësen Anduena Nipolli;
- Me urdhrin nr. 276/3, datë 2.9.2024, për punonjësen Xheni Sallja;
- Me urdhrin nr. 276/4, datë 2.9.2024, për punonjësen Fabjola Lamçja;
- Me urdhrin nr. 276/5, datë 2.9.2024, për punonjësin Ivan Asllani;
- Me urdhrin nr. 276/6, datë 2.9.2024, për punonjësen Morena Bezati;
- Me urdhrin nr. 276/7, datë 2.9.2024, për punonjësin Enis Dobra;
- Me urdhrin nr. 276/8, datë 2.9.2024, për punonjësen Marsela Hoxha;
- Me urdhrin nr. 276/9, datë 2.9.2024, për punonjësen Sofije Ago;
- Me urdhrin nr. 276/10, datë 2.9.2024, për punonjësen Matilda Broshka;
- Me urdhrin nr. 276/11, datë 2.9.2024, për punonjësen Romina Merdani;
- Me urdhrin nr. 276/12, datë 2.9.2024, për punonjësin Mariglen Maraku;
- Me urdhrin nr. 276/13, datë 2.9.2024, për punonjësen Elona Lleshi;
- Me urdhrin nr. 276/14, datë 2.9.2024, për punonjësen Nikita Dedja;
- Me urdhrin nr. 276/15, datë 2.9.2024, për punonjësen Vjosava Mehalla;
- Me urdhrin nr. 276/16, datë 2.9.2024, për punonjësin Arbër Gjini;
- Me urdhrin nr. 276/17, datë 2.9.2024, për punonjësen Erida Balla;
- Me urdhrin nr. 276/18, datë 2.9.2024, për punonjësin Erdison Baxhija;
- Me urdhrin nr. 276/19, datë 2.9.2024, për punonjësen Irisa Çipi.

Në vijim të procesit, njësia përgjegjëse ka ndjekur procedurat e rekrutimit për një numër pozicionesh të lira në shërbimin civil, ku pas përfundimit të konkurrimeve janë shpallur fituesit dhe është kryer emërimi i nëpunësve përkatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi (nga grupi i punës u administruan aktet e emërimit për 15 nëpunës).

Në **pikën 8** të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar që njësia përgjegjëse të sigurojë organizimin e shpalljeve për pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive për pozicionet “*Specialist*”, me kërkesa të njëjta arsimore dhe të posaçme, në formën e grupeve të administrimit të posaçëm. Ky proces duhet të zhvillohet në përputhje të plotë me kërkesat ligjore për pranimin në shërbimin civil, duke garantuar gjithashtu saktësinë dhe përputhshmërinë juridike të akteve që formalizojnë procedurat e rekrutimit.

Nga shqyrtimi i akteve të administruara konstatohet se Bashkia Cërrik ka zhvilluar një sërë procedurash për pranim në shërbimin civil për pozicionet e kategorisë ekzekutive “*Specialist*”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Edhe pse shpalljet nuk janë realizuar në mënyrë të grupuar, në përputhje me rekomandimet për grupimin e pozicioneve që kanë kërkesa të njëjta, ky element nuk ka cënuar vlefshmërinë juridike të procedurave të kryera, pasi kjo kërkesë ka natyrë rekomanduese që synon lehtësimin administrativ të procesit. Si rrjedhojë, procedura konsiderohet e zhvilluar në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Në **pikën 9** të vendimit paralajmërues, Komisioneri i ka kërkuar njësisë përgjegjëse dhe subjekteve të ngarkuara me detyra të administrimit të shërbimit civil, të rregullojnë situatën në lidhje me institutin e konfirmimit dhe deklarimit pas periudhës së provës për 4 punonjës duke ndjekur orientimet e dhëna në këtë vendim.

Në zbatim të pikës 13, të kreut VI, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, vërejt se njësia përgjegjëse (njësia e burimeve njerëzore të institucionit) ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në përfundim të periudhës së provës për konfirmimin e nëpunësve civilë.

Konkretisht:

- Me aktin nr. 1551/2 prot., datë 28.6.2024, Adriana Pupuleku, konfirmohet nëpunëse civile në pozicionin, “*Specialist*”, në Drejtorinë e Aplikimeve të Projekteve;
- Me aktin nr. 1551/3 prot., datë 28.6.2024, Elsa Hoxholli, konfirmohet nëpunëse civil në pozicionin, “*Specialist i Ndihmës Ekonomike*”, në Drejtorinë e Aplikimeve të Projekteve;
- Me aktin nr. 1551/1 prot., datë 28.6.2024, Anita Sade, konfirmohet nëpunëse civile në pozicionin, “*Specialist*”, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore;
- Me aktin nr. 1551/4 prot., datë 28.6.2024, Serxhio Shani, konfirmohet nëpunës civil në pozicionin, “*Specialist*”, në Drejtorinë e Aplikimeve të Projekteve;

Në **pikën 10** të vendimit paralajmërues, në lidhje me mangësitë e konstatuara në dosjen e personelit, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse e bashkisë që të përditësojë dokumentacionin e nëpunëses E. Drazhi, duke përfshirë listën e notave të noterizuar, në

zbatim të nenit 17 të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar, si dhe të pikës 3, germa (ç) të lidhjes 1 dhe pikës 6 të lidhjes 2 të vendimit nr. 833, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave.

Në lidhje me këtë kërkesë, vërej se, grupi i punës është informuar nga ana e njësise përgjegjëse se nëpunësja është përpjekur për të siguruar listën e notave nga institucioni arsimor ku ka përfunduar studimet (*rreth 40 vite më parë*), por kjo listë nuk i është vënë në dispozicion. Kjo situatë është objektive dhe e pavarur nga vullneti i nëpunëses, për shkak të vështirësive reale për të rikuperuar dokumentacionin e vjetër në arkivat universitare të kohës.

- Në kushtet kur njësia përgjegjëse ka administruar në dosjen e personelit diplomën e noterizuar të znj. E. Drazhi, duke përmbushur kërkesën thelbësore për vërtetimin e kualifikimit arsimor, në përputhje me nenin 17 të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar, si dhe
- referuar pikës 3, germa (ç) të lidhjes 1 dhe pikës 6 të lidhjes 2 të VKM-së nr.833/2020, lista e notave administrohet në dosje vetëm në rastet kur nota mesatare është kriter për përzgjedhjen në pozicionin përkatës të punës. Duke pasur parasysh faktin se ky kriter nuk është aplikuar për pozicionin që mban znj. Drazhi, dhe si i tillë, kërkesa për listën e notave ka karakter plotësues dhe jo përcaktues për ligjshmërinë e dosjes,

Vlerësoj se, situata e konstatuar mund të konsiderohet si një mangësi formale e justifikuar, që nuk çënon ligjshmërinë e dosjes së personelit dhe as përputhshmërinë me kërkesat e ligjit dhe aktit nënligjor në fuqi.

Në **pikën 11** të Vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe Njësia përgjegjëse të hartojnë dhe miratojnë një plan veprimi për zbatimin e vendimit paralajmërues, i cili të përmbajë: veprimet administrative që do të ndërmerren, personat përgjegjës për realizimin e tyre dhe afatet konkrete për përfundimin e secilit veprim.

Nga aktet e administruara nga grupi i punës, konstatoj se është hartuar dhe miratuar plani i veprimit me aktin nr. 2354 prot., datë 9.10.2024, "*Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, bazuar në vendimin nr. 53, datë 23.9.2024 ...*", të Sekretarit të Përgjithshëm, në të cilin janë përcaktuar qartë detyrat konkrete, personat përgjegjës për kryerjen e tyre, afatet për përfundimin e veprimeve administrative, si dhe dokumentacioni që duhet të prodhohet në zbatim të këtyre detyrave.

Nisur nga sa më sipër, çmoj se, nga ana e institucionit, Bashkia Cërrik janë kryer veprimet administrative të nevojshme për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Paralajmërues Nr.53, datë 23.9.2024, të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar).

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 53, datë 23.9.2024, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Bashkia Cërrik dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Cërrik duke zbatuar detyrat e lëna të dispozitivit të Vendimit nr.53, datë 23.9.2024.
3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Cërrik.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha